



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.261, datë 23.07.2020

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E
LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR.86, DATË 26.02.2020, PËR KANDIDATEN
ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23.07.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020, si dhe propozimin për përfundimin e kësaj procedure për kandidaten znj. {...},

VËREN

I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN DHE KËRKESËN E KANDIDATIT

1. Me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

2. Me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

3. Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020 Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

4. Aktualisht kanë përfunduar afatet e pezulluara¹ dhe më pas të zgjatura² të kandidimit për të treja procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me vendimet e sipërcituara.

5. Brenda afatit të kandidimit, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020 si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

6. Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për znj. {...}, për të cilën, pas zhvillimit të shortit, caktoi si relator z. Alban Toro. Gjithashtu, me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për znj. {...}, për të cilën vendosi që procedura e verifikimit e filluar më parë³ është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020.

7. Në vijim, nga ana e relatorit filloi kryerja e veprimeve përgatitore dhe verifikuese si dhe dërgimi i shkresa institucioneve përkatëse për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidates për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, në përputhje me përcaktimet e pikës 15, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019.

¹ Më datë 12.03.2020.

² Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

³ Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020.

8. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr.82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, ku është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”⁴, “c”⁵ dhe “ç”⁶, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”, në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve të kandidimit, të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për kandidaten znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës administrative dhe civile, Këshilli me Vendimin nr.214, datë 18.06.2020 ka vendosur:*

“1.Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr.86, datë 26.02.2020...”.

9. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme dhe procedurat janë në përfundim.

10. Përveç sa sipër, Këshilli në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë kushtetuese për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor si dhe të zhvillimit të karrierës gjyqësore, vendosi që të hapte procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm si dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Konkretisht, Këshilli vendosi hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të

⁴ Në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

⁵ Në shkronjën “c” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

⁶ Në shkronjën “ç” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

përgjithshëm për katërmbëdhjetë pozicioneve të lira, në fushën e të drejtës civile dhe penale, (Vendimet nr. 173-186)⁷ si dhe hapjen e procedurave për dy pozicione të lira, për Gjykatën Administrative të Apelit (Vendimet nr. 187 dhe nr. 188).

⁷ *Vendimi nr. 173, datë 28.05.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

Vendimi nr. 174, datë 28.05.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Vendimi nr. 175, datë 28.05.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 176, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 177, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Vendimi nr. 178, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 179, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 180, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 181, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 182, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 183, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Vendimi nr. 184, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Vendimi nr. 185, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Vendimi nr. 186, datë 28.05.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

11. Afati i kandidimit për të gjitha këto procedura ishte dy javë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e publikimit të vendimeve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, afat që rezultoi të ketë përfunduar më datë 15.06.2020.

12. Brenda afatit të kandidimit, për dy pozicionet e lira, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020, ka kandiduar edhe gjyqtare {...}.

13. Këshilli, në mbledhjen plenare të datës 02.07.2020, mori në shqyrtim Projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 28.05.2020”. Gjatë shqyrtimit të këtij projektvendimi, Këshilli mbasi vuri në diskutim të drejtën e kandidimit sipas nenit 48, pika 6, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vlerësoi se në kuptim të nenit 48, pika 6, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gjyqtari mund të kandidojë për ngritjen në detyrë në rastin e çdo shpallje, por në total në jo më shumë se tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, të cilat janë në proces (nuk kanë përfunduar), pavarësisht kohës së shpalljes së tyre.

14. Pas këtij qëndrimi dhe mbas konstatimit se, kandidatja znj. {...} ka kandiduar në total, **për 5 (pesë) pozicione të lira në proces** (për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr.179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020), Këshilli e ftoi këtë kandidatë që të **ri konsideronte tre pozicionet e lira për të cilat do të vijonte kandidimin duke i kërkuar, të përcaktonte tre mes pesë pozicioneve që ka kandiduar dhe që janë në proces.**

15. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, më datë 03.07.2020, në rrugë elektronike, protokolluar me aktin nr. 1758/2 prot., datë 03.07.2020, kandidatja ka parashtruar se: “Në përgjigje të emalit tuaj ku më ftoni të zgjedh ndërmjet 5 vakancave ku kam konkurruar, tre prej tyre, pavarësisht se nuk ndaj të njëjtin mëndin në lidhje me mënyrën se si interpretohet dispozita ku ju referoni, zgjedh

të vijojë konkurrimin për vakancat në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr.82 dhe nr. 83 datë 26.02.2020 dhe vakancën në Gjykatën e Apelit Tiranë, juridiksioni i përgjithshëm në fushën e të drejtës civile shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020”.

16. Në këtë mënyrë, kandidatja, duke përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijojë konkurrimin, konkretisht, dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, si dhe pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, ajo ka hequr dorë/është tërhequr nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

17. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky relacion bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

II. KONKLUZIONE

18. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezultoi që kandidatja z. znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli i lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve

të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR